



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË ARTEVE

Tetovë, 2023

PËRMBAJTA

1. Qëllimi i procesit yë vetevaluimit.....	3
2. Përshkrimi i Fakultetit.....	4
2.1. Historiku.....	4
2.2. Misioni.....	4
2.3. Strategjia e zhvillimit.....	5
3. Struktura organizative e Fakultetit.....	6
3.1. Organogrami.....	6
3.2. Programet studimore.....	7
4. Veprimtaria mësimore.....	11
5. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor.....	13
6. Struktura e studentëve.....	19
6.1. Struktura e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve.....	18
6.2. Struktura e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimev.....	20
7. Anketimi i studentëve.....	21
8. Veprimtaria shkencore e srtistike si dhe pjesëmarrja në projekte.....	24
9. Hapësirat dhe resurset materiale.....	26
10. SWOT Analiza.....	29
11. Konkludim.....	30

1. Qëllimi i procesit të vetevaluimit

Evaluumii cili u organizua në kuadër të Fakultetit të Arteve, kishte për qëllim të bëjë vlerësimin e procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies e cila do të shërbejë për rritje të kualitetit të procesit mësimor. Gjatë këtij procesi të evaluimit ku ishin të inkuadruar kadri arsimor si dhe studentët, njëherësh u vlerësua edhe puna dhe kushtet në të cilat është zhvilluar procesi edukativo-mësimor. Mes tjerash, u bë edhe vlerësimi i programeve mësimore, me theks të veçantë për të rishikuar edhe një herë përputhshmërinë e tyre me Sistemin e Bolonjës. Konkretisht, në proces të evaluimit u përfshinë:

- vlerësimi i programeve studimore ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore;
- struktura e kuadrit mësimor-shkencor;
- përshkrimi i realizimit të mësimdhënies;
- vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor;
- studentët, struktura e studentëve dhe anketimi i studentëve që vlerësojnë më tepër komponentë;
- struktura e kuadrit administrativ dhe teknik;
- hapësirat dhe mjetet e realizimit të procesit mësimor.

Procesi i evaluimit në kuadër të Fakultetit të Arteve pati një rrjedhë tejet normale dhe u zhvillua në një atmosferë pune, ndërsa bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ishin në nivelin e duhur. Gjatë këtij procesi ishin inkuadruar të gjitha subjektet dhe strukturat që veprojnë në kuadër të Fakultetit, dekanati, administrata, të cilat i vunë në shfrytëzim të gjitha materialet dhe informacionet e disponueshme nga administrata, materialet e përdorura, subjektet e inkuadruara, si dhe bashkëpunimin gjatë realizimit të procesit të evaluimit.

2. Përshkrimi i Fakultetit

2.1. Historiku

Universiteti i Tetovës është themeluar më 17 dhjetor 1994, si iniciativë qytetare ndërsa prej shkurtit të vitit 2004 nga Qeveria e RM-së me ligj të veçantë Universiteti i Tetovës fitoi statusin e institucionit të lartë arsimor në Republikën e Maqedonisë me seli në Tetovë. Në kuadër të Universitetit të Tetovës më 1994 është themeluar edhe:

- Fakulteti i **Arteve Figurative** me katër drejtime artistike: **Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Dizajn Grafik;**
- Fakulteti i **Artit Muzikor** me drejtimet: **Teoria e muzikës dhe e pedagogjisë, Solo këndimi, Piano, Instrumentet me hark**
- Fakulteti i **Artit Dramatik** me drejtimin **Aktrim** i cili themelohet në vitin 1995.

Me zyrtarizmin e Universitetit të Tetovës në Universitet Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004 themelohet Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Arteve, funksionojnë programet studimore: Art Figurativ dhe Art Muzikor.

Në vitin 2007 me akreditimin e programeve të reja duke u bazuar në Kartën e Bolonjës themelohet Fakulteti i Arteve si njësi akademike në kuadër USHT-së. (*Tabela 1*).

Tabela 1. Programet studimore në kuadër të Fakultetit të Arteve

	Programi studimor	Vitit i themelimit
1	Art Figurativ	1994
2	Art Muzikor	1994
3	Art Dramatik	1995

2.2. Misioni

Misioni i Fakultetit të Arteve është që fillimisht të krijojë kuadër të ardhshëm arsimor të mirëfilltë të arteve dhe artistë të ardhshëm të cilët do të lënë gjurmë afatgjatë në krijimtarinë artistike. Roli dhe detyra e Fakultetit të Arteve është realizimi dhe organizimi i studimeve sipas

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

programeve studimore, të ciklit të parë dhe të dytë; realizimi i kërkimeve fundamentale, zhvillimore e të aplikuara dhe realizimi i veprimtarive aplikative; transmetimi i njohurive e aftësive shkencore, profesionale e artistike etj.

- Ofrimi i programeve dhe mjedisit studimor cilësor;
- Kultivimi i vlerave të një shoqërie demokratike, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe diverse;
- Sigurimi i një mjedisi të kultivuar, miqësor dhe bashkëpunues brenda institucionit;
- Avancimi i dijes, mendimit kritik dhe kreativitetit;
- Zhvillimi i kuptimit të plotë, të saktë dhe kritik, ndaj artit, kontekstit të tij dhe marrëdhënieve ndërmjet artit dhe shoqërisë;
- Zgjerimi i praktikës artistike në sferën publike, duke përdorur më shumë lloje dhe forma të ekspozimit, skenës muzikore, teatrit, filmit etj;
- Komunikimi në mënyrë vizuale, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për t'u angazhuar audiencia etj.

2.3. Strategjia e zhvillimit


Fakulteti i Arteve është i përkushtuar të ofrojë mësimdhënie gjithnjë e më cilësore. Në përputhje me zhvillimet aktuale dhe të ardhshme, Fakulteti i Arteve në secilin program studimor dhe drejtim, ku organizon studime do të ofrojë:

- Mësimdhënie interaktive të bazuar në teori dhe praktikat më të mira bashkëkohore ku në qendër do ta ketë studentin/en;
- Mësimdhënie, që integron pjesën relevante praktike në përputhje me specifikat e programeve përkatëse të studimit;
- Mësimdhënie e mbështetur në punë dhe projekte hulumtuese sipas specifikave;
- Mësimdhënie e bazuar në një raport të arsyeshëm për kontekstin profesor – student, duke shkuar drejt zbatimit të standardeve evropiane.
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet e tjera simotra në vend dhe jashtë vendit.

- Përmirësimi i procesit të vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies dhe programeve etj.

3. Struktura organizative e fakultetit

3.1. Organogrami



Organet e Fakultetit janë Këshilli mësimor - shkencor, dekani dhe dekanati.

Këshilli mësimor-shkencor

Këshilli mësimor-shkencor është organ menaxhues dhe organ profesional i Fakultetit. Këshilli mësimor-shkencor përbëhet nga profesorë ordinarë, inordinarë dhe docentë të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultet.

Përfaqësuesit e studentëve përbëjnë 10% (dhjetë për qind) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit mësimor-shkencor dhe zgjidhen për një mandat prej dy vjetësh pa të drejtë rizgjedhjeje. Numri i studentëve në Këshillin mësimor-shkencor është i ndryshueshëm në varësi të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit mësimor-shkencor.

3.2. Programet studimore

Programet studimore në kuadër të Fakultetit të Arteve kanë për qëllim realizimin dhe organizimin e studimeve sipas programeve të parapara për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve që në radhë të parë të krijojnë kuadër të ardhshëm arsimor të arteve dhe artistë të artit figurativ, muzikor dhe dramatik.

Për të vlerësuar cilësinë e kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, menaxhimin, aktivitetet akademike dhe aktivitetet tjera dhe përparësitë e tyre, Fakulteti kryen vetevaluim në interval kohe prej më së shumti 3 vjetëve.

Metodat e ligjëritimit, ushtrimeve dhe aktiviteteve tjera të programeve studimore që përdoren janë sipas standardeve të fushave përkatëse dhe ofrojnë mundësi maksimale për përvetësimin e programeve studimore. Studenti është në qendër të vëmendjes, duke i ofruar interaktivitet dhe përfshirje të plotë në të gjitha aktivitetet, me të cilat vijnë në shprehje afinitetet e tij.

Vlerësimi kryhet vazhdimisht gjatë gjithë semestrit, duke krijuar komunikim të mirë gjatë ndjekjes së aktiviteteve dhe përparimit me qëllim që të karakterizohet me objektivitet, relevancë dhe transparencë. Secili mësimdhënës është i detyruar t'i njoftojë studentët me standardet, procedurat dhe kriteret e vlerësimit duke marrë parasysh elementet e ndryshme siç janë aktivitetet e studentëve, prezantimet, detyrat, puna e pavarur etj.

Literatura e detyrueshme dhe plotësuese e shënuar në programin e lëndëve, është literaturë të cilën e kanë në dispozicion studentët e programeve studimore aktuale. Zgjerimi dhe sigurimi i literaturës së detyrueshme dhe plotësuese për çdo lëndë në veçanti, është e drejtë autonome e çdo mësimdhënësi–bartësi të lëndës. Mësimdhënësi i lëndës është bartës i literaturës adekuate dhe studentëve ua jep në fillim të çdo semestri. Mësimdhënësi literaturën e shënon në programin e lëndës (syllabus). Studentët kanë qasje të lirë në botimet elektronike të librave dhe revistave me çka u mundësohet njohje me literaturën relevante në nivel evropian dhe botëror. Programet studimore aktuale (programet studimore të akredituara në vitin 2014) të ciklit të parë dhe të dytë përmbajnë lëndë obligative dhe zgjedhore. Lëndët obligative janë nga fushat përkatëse e programeve studimore. Lëndët mësimore zgjedhore studentët i zgjedhin nga lista e

lëndëve mësimore zgjedhore e programeve studimore që kanë numër të barabartë të ECTS kredive. Në listën e lëndëve mësimore zgjedhore përfshihen gjithashtu lëndë mësimore që mësohen në njësi tjera të universitetit. Përpos lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore, në programet studimore janë të parapara edhe lëndë opsionale (lëndët e lira zgjedhore) ku studentët mund të fitojnë njohuri dhe kredi nga këto lëndë. Në programin studimor të ciklit të parë të studimeve në artin figurativ parashihet edhe punimi përfundimtar (punimi i diplomës), i cili përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike (dhjetë punime të realizuara).

Fakulteti i Arteve në vitin akademik 2021/2022 ka filluar punën me programet e riakredituara në vitin 2021. Në këto programe janë paraparë lëndë obligative dhe zgjedhore. Programet studimore të ciklit të parë të studimeve sigurojnë kompetenca dhe aftësi profesionale të studentëve që përfundojnë studimet. Këto programe u mundësojnë studentëve qasje më të mirë ndaj profesionit në përputhje me kornizën kombëtare të kualifikimeve profesionale si dhe, sigurojnë arsimim të përhershëm dhe njohuri bashkëkohore profesionale dhe shkencore/artistike të kuadrove në fushën e arteve. Me këtë, kuadrove të reja u mundësohet qasje në profesione të ndryshme që ofrojnë përgjigje gjithëpërfshirëse për nevojat e tregut të punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas standardeve për kuadrin mësimor, studentët e drejttimeve pedagogjike pas diplomimit mund të punësohen para së gjithash si profesorë të artit në arsimin e mesëm - gjimnaz, arsimin e mesëm profesional, arsimin e mesëm artistik, arsimin fillor etj., ndërsa ata të drejttimeve artistike duhet të japin edhe provimet e rikualifikimit. Gjithashtu mund të punësohen edhe në institucione profesionale artistike si galeri të arteve, muze, teatër, radiotelevizione, qendra për kulturë etj. Programe të ngjashme studimore të ciklit të parë të studimeve, janë të përfshira në një numër të madh të universiteteve në rajon e më gjerë dhe në masë të madhe korrespondojnë me hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku lëndët që mësohen janë të përfshira në universitetet më të mira në Evropë. Programet studimore në masë të madhe janë të harmonizuara me shumë programe studimore nga hapësira e vetme evropiane e arsimit të lartë dhe jep mundësi për lëvizjen e stafit akademik dhe studentëve.

Niveli në Kornizën Nacionale të Kualifikimit të Arsimit të Lartë		Arsimi i lartë	Niveli në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë
VII	VIIA	Cikli II i studimeve Studime akademike të magistraturës 60 kredi	7
VI	VIA	Cikli I i studimeve Studime universitare 240 kredi	6

Cikli i parë

Për realizimin e veprimtarisë së tij Fakulteti i Arteve është i organizuar në njësi të brendshme organizative në përputhje me Statutin e Universitetit dhe atë:

I - Programet studimore

Tabela. 2a Drejtimet dhe kualifikimi

PROGRAMI	DREJTIMI	S	ECTS	KUALIFIKIMI
ART FIGURATIV	Pedagogjik	8	240	Mësimdhënës i diplomuar i artit figurativ - piktor, skulptor apo grafist
	Pikturë			Piktor i diplomuar
	Grafikë			Grafist i diplomuar
	Skulpturë			Skulptor i diplomuar
	Dizajn grafik			Dizajner grafik i diplomuar
ART MUZIKOR	Teorik - pedagogjik	8	240	Pedagog i diplomuar i muzikës
	Dirigjim			Dirigjent i diplomuar
	Kompozim			Kompozitor i diplomuar
	Muzikologji			Muzikolog i diplomuar
	Etnomuzikologji			Etnomuzikolog i diplomuar
	Vokalo - instrumental			
	Solo këndim			Solo këngëtar i diplomuar

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

	Piano			Pianist i diplomuar
	Violina			Violinist i diplomuar
	Viola			Violist i diplomuar
	Violonçel			Violonçelist i diplomuar
	Kontrabas			Kontrabasist i diplomuar
	Kitarë			Kitarist i diplomuar
	Flaut			Flautist i diplomuar
	Klarinet			Klarinetist i diplomuar
	Oboa			Oboist i diplomuar
	Fagot			Fagotist i diplomuar
	Tubë			Tubist i diplomuar
	Korno			Kornist i diplomuar
	Trombon			Trombonist i diplomuar
	Instrumente me goditje			Perkusionist i diplomuar
	Fizarmonikë			Fizarmonicist i diplomuar
ART DRAMATIK	Aktrim	8	240	Aktor i diplomuar
	Dramaturgji			Dramaturg i diplomuar
	Regji teatri			Regjisor teatri i diplomuar
	Regji filmi dhe TV			Regjisor filmi dhe televizioni i diplomuar
	Kinematografi			Kinematograf i diplomuar
	Montazhë			Montazher i diplomuar

Cikli i dytë

Programi studimor

Tabela 2b Drejtimet - modulet dhe kualifikimi

PROGRAMI	DREJTIMI (modulet)	S	ECTS	KUALIFIKIMI
ART FIGURATIV	Pikturë	2	60	Magjistër i artit figurativ + emri i modulit
	Skulpturë			
	Grafikë			
	Dizajn grafik			

4. Veprimtaria mësimore

Në të tri programet studimore të Fakultetit të Arteve organizohen studime të ciklit të parë që janë kompatible me Sistemin Evropian të Kredive (ECTS) në të cilat përgatiten kuadro të profileve të ndryshme nga fusha e arteve. Çdo program studimor në vete përmban disa drejtime: drejtimin pedagogjik si dhe një numër të caktuar të drejtimeve artistike (*Tabela 2a*).

Në Fakultetin e Arteve në programin studimor Art Figurativ realizohen studime edhe të ciklit të dytë, në disa drejtime - module të caktuara (*Tabela 2b*).

Në Fakultetin e Arteve procesi mësimor realizohet me mësim teorik dhe praktik. Mësimdhënia realizohet sipas dinamikës së paraparë në programin e Fakultetit të Arteve. Për realizimin e procesit mësimor gjegjësisht të pjesës praktike përdoren hapësirat e fakultetit me pajisjet përkatëse, kurse pjesa pedagogjike realizohet në shkollat fillore me të cilat është nënshkruar marrëveshje paraprake për bashkëpunim. Gjithashtu, në të gjitha programet studimore, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë.

Studimet e ciklit I (parë) zgjasin katër vite akademike (tetë semestra) dhe studentët fitojnë gjithsej 240 kredi. Studimet e ciklit II (dytë) zgjasin një vit akademik (dy semestra) me gjithsej 60 kredi.

Me mbrojtjen e suksesshme të punimit të diplomës, studenti merr diplomë për studimet e kryera dhe thirrjen përkatëse:

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

Në programin studimor - Art Figurativ

Pas diplomimit në ciklin I (e parë) të studimeve, studentët e drejtimit pedagogjik marrin diplomën me thirrjen:

- Mësimdhënës i diplomuar i artit figurativ - piktor, skulptor apo grafist (*varësisht nga moduli i zgjedhur*), ndërsa studentët e drejtimeve artistike marrin diplomën me thirrjen:
 - Piktor i diplomuar,
 - Skulptor i diplomuar,
 - Grafist i diplomuar,
 - Dizajner grafik i diplomuar.

Pas mbarimit të ciklit II (të dytë) të studimeve, studentët marrin titullin: Magjistër i artit figurativ +(moduli) pikturë, skulpturë, grafikë ose dizajn grafik.

Në programin studimor - Art Muzikor

Pas diplomimit në fusha përkatëse profesionale dhe artistike studentët marrin diplomën me thirrjen:

- Pedagog i diplomuar i muzikës
- Dirigjent i diplomuar
- Kompozitor i diplomuar
- Muzikolog i diplomuar
- Etnomuzikolog i diplomuar
- Solo këngëtar i diplomuar
- Pianist apo klarinetist i diplomuar (*varësisht nga moduli i zgjedhur*)

Në programin studimor - Art Dramatik

Pas diplomimit në fusha përkatëse profesionale dhe artistike studentët marrin diplomën me thirrjen:

- Aktor i diplomuar
- Dramaturg i diplomuar
- Regjisor teatri i diplomuar
- Regjisor filmi dhe TV i diplomuar
- Kinomatograf i diplomuar
- Montazher i diplomuar

Fakulteti i Arteve ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Universitetet tjera rajonale. Vlen të përmendet bashkëpunimi me Universitetet shqiptare edhe atë me Universitetin e Arteve në Tiranë dhe Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, si në planin e përafrimit të planprogrameve mësimore, por edhe në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në planin artistik siç është “Ura me Tri Harqe”, e cila realizohet çdo vit sipas rrotacionit. Bashkëpunim të rregullt ka me Akademinë e Arteve pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit dhe me disa universitete të Turqisë, Bullgarisë, etj. Procesi arsimor-shkencor e artistik në Fakultetin i Arteve realizohet në dy objekte në Tetovë.

5. Struktura e kuadrit mësimor - shkencor

Në fakultetin e Arteve, gjatë periudhës nga viti akademik 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 procesin arsimor e kanë realizuar gjithsej 32 mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit mësimor, mësimor-shkencor të Fakultetit të Arteve është realizuar në përputhje me kriteret e parapara në Ligjin për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Statutin e Universitetit të Tetovës si dhe Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë - shkencorë, shkencorë, mësimorë - profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës. Për realizimin e procesit mësimor përveç kuadrit të rregullt kanë qenë të angazhuar me kontratë edhe një numër i caktuar i

mësimdhënësve. Ky numër ka qenë i ndryshueshëm përgjatë viteve për shkak të drejtimeve që kanë pauzuar si dhe numrit të studentëve që janë regjistruar.

Raporti gjinor i mësimdhënësve të rregullt në Fakultetin e Arteve nuk është i balancuar pasi vetëm 7 mësimdhënës apo 21.8% e tyre i përket gjinisë femërore.

Në tabelat e radhës sipas programeve studimore janë pasqyruar numri i mësimdhënësve dhe i bashkëpunëtorëve të rregullt dhe të angazhuar me kontratë përgjatë viteve akademike të lartpërmendura.

Programi studimor Art Figurativ

Në programin studimor Art Figurativ në kuadër të Fakultetit të Arteve me marrëdhënie të rregullt pune, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/21 dhe 2021/22 kanë qenë gjithsej 18 mësimdhënës. Në vitin akademik 2019/2020 nga numri i përgjithshëm i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune kanë qenë gjithsej 18, prej të cilëve 4 i takojnë gjinisë femërore ose 22% e mësimdhënësve. Po ashtu ka pasur edhe 2 bashkëpunëtorë të jashtëm të angazhuar prej të cilëve njëra femër, respektivisht 50%. (**Tabela 3a**). Duke marrë parasysh numrin e studentëve të regjistruar në programin studimor Art Figurativ gjatë viteve akademike të lartpërmendura konstatojmë se një mësimdhënës bashkëvepron me gjashtë studentë, numër i pëlqyeshëm për realizim të mirëfilltë të procesit mësimor.

Tabela 3a. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor Art Figurativ

ART FIGURATIV									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2019/2020									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	9	/	9	50-63	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	5	2	7	42-62	Inordinar	/	/	/	/
Docent	/	2	2	31-41	Docent	/	/	/	/
Asistent	/	/	/		Mr.	1	1	2	37-42

I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	/	/	/	/
Gjithsej	14	4	18		Gjithsej	1	1	2	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2020/2021									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	9	/	9	51-64	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	5	2	7	43-63	Inordinar	/	/	/	/
Docent	/	2	2	32-42	Docent	/	/	/	/
Asistent	/	/	/		Mr.	1	1	2	38-43
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	/	/	/	/
Gjithsej	14	4	18		Gjithsej	1	1	2	/
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2021/2022									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	11	/	11	52-65	Ordinar	/	/	/	
Inordinar	3	2	5	44-64	Inordinar	/	/	/	
Docent	/	2	2	33-43	Docent	/	/	/	
Asistent	/	/	/		Mr.	1	1	3	39-44
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	/	/	/	
Gjithsej	14	4	18		Gjithsej	1	1	2	

Programi studimor Art Muzikor

Në programin studimor Art Muzikor në kuadër të Fakultetit të Arteve, me marrëdhënie të rregullt pune, në periudhën nga viti akademik 2019/2020, 2020/2021 kanë qenë gjithsej 10 mësimdhënës, prej të cilëve 3 i takojnë gjinisë femërore ose 30% e mësimdhënësve kurse në vitin akademik 2021/2022 kanë qenë gjithsej 9 mësimdhënës, prej të cilëve 3 i takojnë gjinisë femërore ose 33% e mësimdhënësve.

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

Për realizimin e procesit mësimor po ashtu kanë qenë të angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm (**Tabela 3b**). Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në programin studimor Art Muzikor gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/22, shohim se një mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune apo bashkëpunëtor i jashtëm ka ndjekur punën individuale të tre deri katër studentëve.

Tabela 3b. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor Art Muzikor

ART MUZIKOR									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2019/2020									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	5	/	5	37-64	Ordinar	3	3		53-62
Inordinar	2	2	4	34-57	Inordinar	1			48-78
Docent	/	1	1	38	Dr.	2			48
Asistent	/	/	/		Mr.	4	4		24-38
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar		1		
Gjithsej	7	3	10		Gjithsej	10	8	18	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2020/2021									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	5	/	5	38-65	Ordinar	3	2	5	54-63
Inordinar	2	2	4	35-58	Inordinar	1	/	1	49-79
Docent	/	1	1	39	Dr.	2	/	2	49
Asistent	/	/	/		Mr.	4	3	7	25-39
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar		1	1	
Gjithsej	7	3	10		Gjithsej	10	6	16	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik									

2021/2022									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	6	0	6	39-66	Ordinar	3	1	4	55-64
Inordinar	/	2	2	36-59	Inordinar	/	/	/	50-80
Docent	/	1	1	40	Dr.	2	/	2	50
Asistent	/	/	/		Mr.	3	3	6	26-40
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	/	/	/	
Gjithsej	6	3	9		Gjithsej	8	4	12	

Programi studimor Art Dramatik

Në programin studimor Art Dramatik në kuadër të Fakultetit të Arteve me marrëdhënie të rregullt pune në vitin akademik 2019/2020 kanë qenë gjithsej 4 mësimdhënës kurse në vitet akademike 2020/2021 dhe 2021/2022 kanë qenë gjithsej 5 mësimdhënës dhe të gjithë të gjinisë mashkullore. Për realizimin e procesit mësimor po ashtu kanë qenë të angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm (*Tabela 3c*).

Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në programin studimor Art Dramatik, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, shohim se një mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune apo bashkëpunëtor i jashtëm ka ndjekur punën individuale të tre studentëve.

Tabela 3c. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt, dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor Art Dramatik

ART DRAMATIK									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2019/2020									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	2	/	2	49-50	Ordinar	4	/	4	50-64
Inordinar	/	/	/		Inordinar	1	/	1	47-52

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

Docent	2	/	2	46-49	Dr.	1	1	2	40-47
Asistent	/	/	/		Mr.	3	/	3	27-35
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	3	/	3	
Gjithsej	4	/	4		Gjithsej	12	1	13	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2020/2021									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	2	/	2	50-51	Ordinar	4	/	4	50-64
Inordinar	2	/	2	41-45	Inordinar	1	/	1	47-52
Docent	1	/	1	50	Dr.	/	/	/	
Asistent	/	/			Mr.	3	/	/	27-35
Diplomuar	/	/			Diplomuar	3	/	/	
Gjithsej	5	/	5		Gjithsej	11	/	11	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2021/2022									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	2	/	2	51-52	Ordinar	4	/	4	52-64
Inordinar	3	/	3	42-51	Inordinar	/	/	/	/
Docent	/	/	/		Dr.	/	/	/	/
Asistent	/	/	/		Mr.	4	/	4	27-35
I/e diplomuar	/	/	/		I/e diplomuar	2	/	2	26-40
Gjithsej	5		5		Gjithsej	10	/	10	

Administrata e Fakultetit të Arteve

Në Fakultetin e Arteve, çështjet administrative menaxhohen nga gjithsej 20 administratorë prej të cilëve 2 janë të gjinisë femërore ose 10%. Sa i përket arsimimit 2 janë me studime të magjistraturës, 16 me arsim të lartë dhe 3 me arsim të mesëm. Raporti administratorë/referentë ndaj studentëve është afërsisht 1:6.5. Ndërsa për mbarëvajtjen e punëve teknike janë të angazhuar gjithsej 3 punëtorë teknikë.

6. Struktura e studentëve

6.1. Struktura e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve

Tabela 4a. Numri i studentëve të regjistruar në Fakultetin e Arteve, cikli i parë i studimeve, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022

PROGRAM	I STUDIMOR	Viti akademik	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej	Projekt 35/45	SH. H.	Nacionaliteti
1	Art Figurativ	2019/2020	77	/	77	/	3	2
		2020/2021	64	/	64	/	3	/
		2021/2022	64	/	64	/	2	/
2	Art Muzikor	2019/2020	34	/	34	/	8	2
		2020/2021	31	/	31	/	8	2
		2021/2022	37	/	37	/	13	2
3	Arti Dramatik	2019/2020	23	/	23	/	7	/
		2020/2021	30	/	30	/	10	/
		2021/2022	31	/	31	/	10	/

6.2. Struktura e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve

Tabela 4b. Numri i studentëve të regjistruar në programin studimor Art Figurativ, cikli i dytë i studimeve, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022

	PROGRA MI STUDIM OR	Viti akademik	Të rregul lt	Me korrespondenc ë	Gjithsej	Projek t 35/45	SH. H.	Nacionalit eti
1	Art Figurativ	2019/2020	3	/	3	/	/	/
		2020/2021	3	/	3	/	/	/
		2021/2022	/	/	/	/	/	/

Promovimi i fakultetit

Promovimi i Fakultetit të Arteve bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Gjatë muajit prill, përfaqësues të UT-së realizojnë prezantime para maturantëve të shkollave të mesme në qytete të ndryshme të RMV-së, por edhe në vendet fqinje. Në këto prezantime maturantët për së afërmi njoftohen me fakultetet, programet studimore, si dhe mundësitë tjera për studime që i ofron UT-ja. Pjesa tjetër e promovimit të Fakultetit të Arteve bëhet gjatë ditëve të hapura, ku maturantët kanë mundësi për së afërmi të përjetojnë hapësirat si dhe mundësitë tjera që ofron ky fakultet. Të drejtë për aplikim dhe regjistrim në ciklin e parë të studimeve universitare kanë personat që kanë dhënë provimin e maturës shtetërore, maturës ndërkombëtare ose maturës shkollore të arsimit të mesëm dhe që i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit për regjistrim. Të gjithë kandidatët që kanë aplikuar i janë nënshtruar kontrollit të njohurive dhe shkathtësive të parapara për Fakultetin e Arteve, gjegjësisht të programeve studimore përkatëse. Në Fakultetin e Arteve në vitin akademik 2019/2020, numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 135 studentë. Prej tyre 13.33% kanë qenë nga shtete të tjera dhe 2.96% u takojnë nacionaliteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin akademik 2020/2021 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 125 studentë. Prej tyre 16.80% kanë qenë nga shtete tjera dhe 1.6% u takojnë nacionaliteteve që

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin akademik 2021/2022 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 132 studentë. Prej tyre 18.93% kanë qenë nga shtete tjera dhe 1.51% u takojnë nacionaliteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. (*Tabela 5*).

Tabela 5. Studentët e regjistruar në Fakultetin e Arteve, cikli i parë i studimeve, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 shprehur sipas numrit dhe përqindjes së shtetasve dhe nacionaliteteve tjera

FAKULTETI I ARTEVE					
Viti akademik	Gjithsej numri i studentëve të regjistruar	Shtete tjera		Nacionalitete tjera	
		Nr.	%	Nr.	%
2019/2020	135	18	13.33	4	2.96
2020/2021	125	21	16.80	2	1.6
2021/2022	132	25	18.93	2	1.51


7. Anketimi i studentëve

Anketimi i studentëve

Vlerësim mbi procesin mësimor kanë realizuar edhe studentët e Fakultetit të Arteve. Studentët janë përgjigjur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje studentët janë përgjigjur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1 që nënkupton që dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5 ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.


Studentët e Fakultetit të Arteve gjithsej kanë dhënë 127 vlerësime, nga të tri programet studimore të fakultetit, përfshirë gjithë vitet studimore. Në nivel të Fakultetit, në të gjithë indikatorët, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjruar ($M = 4.69$). Si vijim, studentët

plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.53$) dhe ushtrimeve ($M = 4.49$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Tendencë për vlerësim më të ulët, por përsëri mbi mesataren e pritur është për lidhshmërinë e materialit për përdorim praktik gjatë orëve të ushtrimeve ($M = 4.39$)




Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin e Arteve

Në programin studimor Art Figurativ, gjithsej janë dhënë 73 vlerësime. Studentët kanë vlerësuar se janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, se ligjëratat dhe ushtrimet janë të qarta dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive si në ligjërata edhe në ushtrime (grafikoni 2). Pavarësisht vlerësimit pozitiv, ka tendencë të dallojë vlerësimi i fillimit dhe përfundimit të procesit mësimor për ligjërata ($M = 4.62$) dhe ushtrime ($M = 4.56$).



Grafikoni 2. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Art Figurativ

Në programin studimor Art Muzikor, gjithsej janë vlerësuar 38 lëndë. Gjithë indikatorët janë me vlerësime pozitive nga studentët (grafikoni 3). Informimi për aktivitetet që priten të realizohen në lëndët e vlerësuara ka vlerësim pozitiv, por më të ulët për dallim prej indikatorëve të tjerë, edhe atë si për ligjërata edhe për ushtrime ($M = 3.97$).



Grafikoni 3. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Art Muzikor

8. Veprimtaria shkencore e artistike si dhe pjesëmarrja në projekte

Gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 Fakulteti i Arteve ka organizuar disa aktivitete shkencore/artistike si konferenca, ekspozita, koncerte, shfaqje teatrale, filma e ngjarje të tjera ndërkombëtare, rajonale dhe vendore. Gjatë çdo përfundimi të vitit akademik, studentët e të gjitha programeve studimore, veçmas, organizojnë prezantime finale publike. Studentët e programit studimor Art Figurativ organizojnë ekspozitën e tyre të fundvitit. Studentët e programit studimor Art Muzikor paraqiten me koncert, kurse ata të Artit Dramatik me shfaqje teatrale para publikut të Tetovës. Vlen të përmendet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta siç është projekti “Ura me Tri Harqe”, që realizohet çdo fundvit sipas rrotacionit me studentët e Universitetit të Arteve në Tiranë dhe Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës. Duhet përmendur se për shkak të kufizimeve të shkaktuar nga pandemia e virusit Covid 19 në vitin 2020 dhe 2021 nuk është realizuar ky aktivitet.

Mësimdhënësit e Fakultetit të Arteve krahas realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve tjera lidhur me të, kanë qenë edhe pjesëmarrës dhe bartës të projekteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Në vazhdim është prezantuar një pjesë e aktiviteteve individuale, grupore dhe kolektive e mësimdhënësve të rregullt të Fakultetit të Arteve sipas programeve studimore.

Programi studimor Art Figurativ

Tabela 7a. Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Art Figurativ

Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt					
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Ekspozita		Simpoziume dhe koloni artistike
			personale	kolektive	
2019/2020	1	11	7	29	12
2020/2021	1	9	4	44	13
2021/2022	2	7	12	33	14

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

Programi studimor Art Muzikor

Tabela 7b. Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Art Muzikor

Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt					
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Pjesëmarrja në projekte		Publikime artistike Interpretim i veprave muzikore
			rajonale	vendore	
2019/2020	3	2	31	3	
2020/2021	1	3	31	6	2
2021/2022	2	3	19	8	4

Programi studimor Art Dramatik

Tabela 7c. Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Art Dramatik

Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt					
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Pjesëmarrja në projekte Festivale teatrore dhe filmike		Shfaqje teatrore, filma
			rajonale	vendore	
2019/2020			9	2	4
2020/2021					2
2021/2022			8	3	3

9. Hapësirat dhe resurset materiale

Hapësirat dhe pajisjet

Fakulteti i Arteve procesin mësimor – shkencor/artistik e realizon në dy objekte në Tetovë. Programi studimor Art Figurativ gjendet tek objekti qendror (objekti ish-Rektorat) ndërsa programi studimor Art Muzikor dhe Art Dramatik gjendet në kuadër të objektit të Qendrës për Kulturë në Tetovë. Po ashtu për realizimin sa më efikas të ligjëratave dhe mësimin praktik shfrytëzohen hapësira edhe të objekteve tjera. Hapësirat dhe pajisjet që përdoren janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme (Tabela 8a, 8b, 8c, 8ç,8d,8e) të specifikuar sipas programeve studimore dhe atë:

Programi studimor Art Figurativ

Tabela 8a. Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor Art Figurativ të Fakultetit të Arteve

	Hapësira	Njësitë	Ulëse	Hapësira m2
1	Kabinet për pikturë	2	12	120
2	Kabineti për skulpturë	1	3	80
3	Kabineti për grafikë	2	16	120
4	Kabineti për dizajn grafik	1	20	80
5	Kabineti për akt	1	10	80
6	Kabineti për teknologji	1	5	80
7	Hapësira administrative	5	30	200
8	Klasa për leksione	2	60	90
	Gjithsej	15	156	850

Tabela 8b. Pajisjet në dispozicion të programit studimor Art Figurativ të Fakultetit të Arteve

	Pajisjet, lloji i pajisjeve	Numri	Qëllimi
1	Kompjuterë	15	Për kuadrin arsimor, administratë, studentë
2	Konektorë interneti	5	Për studentë
3	LCD projektor	1	Për kuadrin arsimor, administrate
4	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor, administrate
5	Printerë	5	Për kuadrin arsimor, administrate,
6	Fotokopjues	1	Për kuadrin arsimor, studentë
7	Kavaletë	40	Për studentë
8	Presë grafike	1	Për studentë
9	Dhomë për përpunimin kimik të pllakave grafike	1	Për studentë
10	Mjete adekuate për punë në skulpturë		Për studentë
11	Prerës qelqi për vitrazhë	1	Për studentë

Programi studimor Art Muzikor

Tabela 8c. Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor Art Muzikor të Fakultetit të Arteve

	Hapësira	Njësitë	Ulëse	Hapësira m2
1	Kabinet për piano	1	3	15
2	Sallë koncertale	1	100	300
3	Zyra e profesorëve	1	6	15
4	Hapësira administrative	2	15	70
5	Klasa për leksione	4	120	160
	Gjithsej	9	244	560

Tabela 8ç. Pajisjet në dispozicion të programit studimor Art Muzikor të Fakultetit të Arteve

	Pajisjet, lloji i pajisjeve	Numri	Qëllimi
1	Kompjuterë	3	Për kuadrin arsimor, administratë, studentë
2	Konektorë interneti	1	Për studentë
3	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor, administratë
4	Printerë	1	Për kuadrin arsimor, administratë,
5	Fotokopjues	1	Për kuadrin arsimor, studentë
6	Piano muri (pianino)	7	Për kuadrin arsimor, studentë
7	Piano gjysëmkoncertale	1	Për kuadrin arsimor, studentë
8	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor, administratë

Programi studimor Art Dramatik

Tabela 8d. Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor Art Dramatik të Fakultetit të Arteve

	Hapësira	Njësitë	Ulëse	Hapësira m2
1	Salla e artit dramatik	1	100	300
2	Kabineti për regji filmi	1	10	40
3	Kabineti për montazhë	1	10	40
4	Kabineti për kamerë	1	10	40
5	Kabineti për fotografi	1	8	30
6	Salla për ushtrime	1	/	80
7	Hapësira administrative	2	30	90
8	Klasa për leksione	2	60	120
	Gjithsej	10	228	740

Tabela 8e. Pajisjet në dispozicion të programit studimor Art Dramatik të Fakultetit të Arteve

	Pajisjet, lloji i pajisjeve	Numri	Qëllimi
1	Konektorë interneti	1	Për studentë
2	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor, administratë
3	Printerë	2	Për kuadrin arsimor, administratë,

Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: arts@unite.edu.mk

10. SWOT Analiza

<p style="text-align: center;">Anët e forta</p> <ul style="list-style-type: none"> • staf i kualifikuar dhe ambicioz; • aplikim i modeleve të reja të mësimdhënies; • përgjegjshmëri në realizimin e procesit mësimor; • raporte të mira midis stafit akademik dhe studentëve; • lidhje të ngushta me tregun e punës; • aktivitet i konsoliduar shkencor/artistik i stafit akademik; • ofrim i programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut. 	<p style="text-align: center;">Anët e dobëta</p> <ul style="list-style-type: none"> • mungesa e shkollave të mesme artistike në vend; • konkurrenca jo e mjaftueshme në përzgjedhjen e kandidatëve në drejtime të caktuara; • mosorientimi me kohë i nxënësve për profesionin që e zgjedhin; • promovimi ndoshta i pamjaftueshëm i programeve studimore në rekrutimin e studentëve të rinj.
<p style="text-align: center;">Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me universitetet me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi; • projekte të përbashkëta me fakultetet e rajonit; • mobilitet të stafit dhe studentëve përmes programit Erasmus. 	<p style="text-align: center;">Kërcënimet</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me tregun e punës; • largimi i të rinjve nga vendi, mungesa e perspektivës. • konkurrenca me universitete tjera publike dhe private në një hapësirë të ngushtë gjeografike.

11. Konkludim

Lidhur me aktivitetet shkencore dhe arsimore, janë marrë hapa të ndryshëm në komunikimin ndërkombëtar dhe kombëtar të cilët me projektet e realizuara gjatë vitit akademik 2019/2020, 2020/21 dhe 2021/2022, kanë pasur ndikim konkret në cilësinë e procesit hulumtues shkencor/artistik e arsimor në institucionin përkatës.

Në kontekst të veprimeve të mëtejshme sugjerohet nga ana e stafit akademik që komunikimi ndërkombëtar të vazhdojë edhe më tej me interes më të madh dhe të mundësohet me të njëjtin veprim edhe shkuarja e profesorëve tanë në cilësi të profesorit në fakultete të ndryshme të fushës së artit në universitetet me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi.

Përfundime dhe sugjerime

Fakulteti i Arteve daton që nga themelimi i Universitetit të Tetovës e deri më sot. Prej themelimit të Universitetit e deri në vitin 2004, Fakulteti i Arteve ka pasur vetëm tri programe studimore, edhe atë: Art Figurativ, Art Muzikor dhe Art Dramatik. Prej vitit 2004 programet studimore: Art Figurativ, Art Muzikor kanë vepruar në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Arteve. Me akreditimin e programeve të reja studimore, Fakultetit të Arteve themelohet si njësi në kuadër të Universitetit të Tetovës (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 81 e vitit 2008), me programet studimore: Art Figurativ, Art Muzikor dhe Art Dramatik. Procesi mësimor realizohet me mësim teorik dhe praktik. Për realizimin e pjesës praktike përdoren hapësirat e fakultetit, kurse për pjesën pedagogjike - shkollat fillore me të cilat ka nënshkruar marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Procesi mësimor realizohet nga gjithsej 32 mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune dhe mbi 28 bashkëpunëtorë (mësimdhënës dhe asistentë) të angazhuar me kontratë pune. Prej numrit të përgjithshëm të stafit akademik të rregullt mund të shihet se më shumë dominon gjinia mashkullore 78.2% kundrejt 21.8% të gjinisë femërore kurse sa i përket mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të angazhuar me kontratë nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të tyre afërsisht është 70% me 30% në favor të gjinisë mashkullore.

Në Fakultetin e Arteve në vitet akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 në të gjitha programet studimore janë regjistruar 392 studentë.

Për më tepër, që të rritet informimi i studentëve për të gjitha çështjet e lartpërmendura si dhe për çështje tjera studentore sugjerohet që:

- Të përpilohet pako informative / broshurë për informim të studentëve të Fakultetit të Arteve;
- Takim i koordinatorit për ECTS dhe shefave të programeve studimore me studentët (çdo fillimvit akademik, në veçanti me ata të vitit të parë) për të prezantuar rolin dhe funksionin e koordinatorit, sistemin e kredive, bartjen e kredive etj.
- Kuti për sugjerime / kritika të studentëve;
- Marrja parasysh dhe reflektimi ndaj sugjerimeve, ankesave dhe kritikave të studentëve nga ana e udhëheqësisë së Fakultetit.

Tetovë, 2023